

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Trumpi minimizon rreziqet që paraqet AI-ja, përmend rivalitetin me Kinën
ADRESA	https://www.koha.net/bote/trumpi-minimizon-rreziqet-qe-paraqet-ai-ja-permend-rivalitetin-me-kinen
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 01:37:26 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 08:48:30 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	954d8934fec8b1ef454a254d2eb232ac10c9547427a9e8a35b6485c060d4f3e4
TEKSTI	4f7e8edb93093fe74187236ba8789840349c60ff6e6a38d9bfc5748bc6a9efa2
PAMJA	991195e994605fb3ecf52c6902b95ca8889e459f6b04e4d92f8f22674e6107a7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	54a6b67c6b2ce5ba5687904041e68165b2d9ca05da9f425d5ef4ec034c7a292b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	339a441950953cdd8a76a2c095ab2238d5bab62fcc252abcef1242a6a5fba2fb
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/54a6b67c6b2ce5ba5687904041e68165b2d9ca05da9f425d5ef4ec034c7a292b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën

Kontribuo →

Letër lexuesit

BOTË

Trumpi minimizon rreziqet që paraqet AI-ja, përmend rivalitetin me Kinën



Foto: Associated Press

Përktheu: Flutura Gashi-Mehmeti



14 shtator 2026 10:48

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalën tonë zyrtar në Viber

Presidenti amerikan, Donald Trump, ka minimizuar rreziqet që paraqet inteligjenca artificiale, pas disa ditësh paralajmërimesh të forta nga ekspertët.

“Ka shumë forca negative që po e ngrenë këtë çështje, edhe pse nuk duhet ta bëjnë, dhe po flasim për gjëra që nuk do të ndodhin”, ka thënë Trumpi gjatë një vizite në Irlandë.

Një nga paralajmërimet ka ardhur nga një ish-studiuues i kompanisë Anthropic, i cili ka thënë se “ka një mundësi të madhe që të gjithë të vdesim në të ardhmen e afërt” nëse ritmi aktual i zhvillimit të inteligjencës artificiale vazhdon.

Të shtunën, drejtues të lartë të industrisë kanë rënë dakord me shqetësimet dhe kanë bërë thirrje për ngadalësimin e zhvillimit.

Trumpi nuk ka folur drejtpërdrejt për këtë ide por ka thënë se “Ne po e kryesojmë Kinën në AI... dhe, sinqerisht, dua që të vazhdojë kështu, sepse kush fiton në AI, fiton”.

Edhe



Botë • 8 o. më parë

Kina kritikon idenë se është përfshirë në “konkurrencë keqdashëse” lidhur me AI-në

Trumpi ka folur në të njëjtën ditë kur studiuesi i AI-së, Jacob Coxon, i cili ishte larguar nga Anthropic disa ditë më parë, i ka thënë BBC-së se punonjësit që po zhvillojnë këto sisteme ishin “vërtet të frikësuar” për të ardhmen e njerëzimit.

Coxon, i cili ka punuar gjithashtu në OpenAI, e ka mirëpritur idenë e ngadalësimit të zhvillimit, por ka thënë se kjo do të duhej të koordinohet me Kinën.

Të shtunën, Elon Musk, pronari i xAI-së, dhe Sam Altman nga OpenAI kanë mbështetur paralajmërimin e kreut të Anthropic, Dario Amodei, se ritmi i zhvillimit duhet të ngadalësohet “për të

Arbëri.

Mustafa: Jam takuar me Kurtin për ta diskutuar platformën time për zhblokimin institucional

Futboll.

Newcastle pëson debakël nga Leeds

Futboll.

Spektakël në Serie A, Interi fiton 5:3 ndaj Udineses

Futboll.

Kosova i luan 4 ndeshje brenda 16 ditësh grumbullim

Arbëri.

VV-ja pas tërheqjes së Sejdiut: Ishte mundësia që çështja e presidentit të zgjidhej, por u bllokua sërish

LAJMET E MBRËMJES.

Mbrojtja kërkon lirim të Thaçit e katër të tjerëve në rastin për pengim të drejtësisë

zvogëluar rrezikun që diçka të shkojë seriozisht keq”.

Drejtori ekzekutiv i Anthropic ka thënë se çdo ngadalësim duhet të jetë i kufizuar, në mënyrë që Kina të mos arrijë përpara.

Çështjet që lidhen me inteligjencën artificiale kanë nxitur një debat të ashpër dhe paraqesin një dilemë për shumë liderë botërorë.

Nga njëra anë, sektori shihet si një mundësi e madhe për të nxitur rritjen ekonomike dhe si një mënyrë për të përmirësuar sistemet e vjetruara digjitale dhe mënyrat e punës.

Por ka pasur edhe një sërë rastesh kur inteligjenca artificiale duket se ka shkuar seriozisht keq.

Edhe



Tech • 12 sht 2026
Eksperti i inteligjencës artificiale bën thirrje për ngadalësim të zhvillimit

Në gusht, OpenAI ka thënë se kishte ngadalësuar trajnimin e disa prej modeleve të saj më të avancuara të AI-së, me qëllim përmirësimin e sigurisë.

Kompania që ka krijuar ChatGPT ka thënë se po shtonte masa të reja pasi agjentët e saj të AI-së kishin anashkaluar masat mbrojtëse dhe kishin hakuar kompaninë e re teknologjike Hugging Face.

Po në të njëjtin muaj është bërë e ditur se dy prej mjeteve më të fuqishme të AI-së në botë kishin krijuar profile të rreme njerëzish për t'i mashtruar ata gjatë përpjekjeve për sulme kibernetike.

Instituti i Sigurisë së AI-së në Mbretërinë e Bashkuar (AIS) ka thënë se, në rastin më serioz, Mythos AI i Anthropic u përpoq të fitonte qasje në një shërbim duke dërguar mesazhe private, pasi kishte krijuar llogari të rreme që imitonin njerëz realë, dhe më pas kishte fshehur provat.

Administrata Trump argumenton se SHBA-ja duhet të ruajë dominimin global në teknologji si çështje të sigurisë kombëtare, megjithëse ka pranuar se duhet treguar vigjilencë ndaj rreziqeve që paraqet kjo teknologji në zhvillim.

Thirrja e drejtuesve të mëdhenj të kompanive të AI-së gjatë fundjavës ka nxitur debat në Uashington, ku ligjvënësit po përballen me presion për të trajtuar rreziqet e mundshme që lidhen me zhvillimin e shpejtë të inteligjencës artificiale.

Të dielën, kryetari i Dhomës së Përfaqësuesve, Mike Johnson, republikani më i lartë në këtë dhomë, ka bërë thirrje për kujdes ndaj përpjekjeve për të nxitur rregullimin e AI-së. Gjatë një interviste për CNN, ai ka argumentuar se një gjë e tillë mund të “mbytyë inovacionin amerikan”.

Edhe



Tech • 10 o. më parë
Aksionet e kompanive të AI bien në gjithë botën pasi drejtorët e tyre kërkojnë ngadalësim të zhvillimit

“Nëse Kongresi thjesht nxiton dhe ndërhyr përmes një seance të jashtëzakonshme për të tentuar të rregullojë AI-në, ne do ta humbasim garën me Kinën dhe ky shtë një kërcënim për çdo amerikan”, ka thënë ai. “Pra, duhet të gjejmë ekuilibrin. Duhet të kemi njerëz të matur në drejtimin e timonit”.

Udhëheqësi i pakicës demokrate në Dhomën e Përfaqësuesve, Hakeem Jeffries, ka bërë ndërkaj thirrje për “veprime vendimtare” nga ligjvënësit.

#DONALD TRUMP

#INTELIGJENCA ARTIFICIALE

#OPEN AI

#CHAT GPT

#RREZIKU

#KINA

Artikuj te ngjashem



Tech • 7 sht 2026

OKB: Inteligjenca artificiale mund të përbëjë rrezik ekzistencial për njerëzimin



Botë • 31 gus 2026

AI-ja e avancuar kërcënon sistemin financiar botëror, thotë organi mbikëqyrës

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë original apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësisë që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing

Politika e privatësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzim për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.